



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

**Mbi transferimin e fondit prej 600 000 Lek te alokuara per projektin  
“Grante per biznese te reja” tek organizata bashkeimplementuese e  
ketij projekti, ARZH (Agjensia Rajonale e Zhvillimit)**

Nr 117 Datë 11.12.2008

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Marketingut dhe Turizmit “Mbi transferimin e fondit prej 600 000 Lek te alokuara per projektin “Grante per biznese te reja” tek organizata bashkeimplementuese e ketij projekti, ARZH (Agjensia Rajonale e Zhvillimit)” si dhe ne zbatim te Ligjit nr 8652 dt. 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” neni 32 pika dh, në ligjin nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë», në ligjin nr 10025 dt. 27.11.2008, “Për buxhetin e vitit 2009”, në Udhëzimin e MF nr 2 dt. 12.01.2009 «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2009» në VKB nr 12 dt 13.02.2009 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2009»

VENDOSI:

1. Te miratoje transferimin e fondit prej 600 000 Lek, i planifikuar ne Buxhetin e Bashkise per vitin 2009 ne llogarine bankare te Agjensise Rajonale te Zhvillimit me kete strukture buxhetore:

Pakesohet	00	01110	05	Art	6060000	- 600 000 Leke
Shtohet	00	01110	05	Art	6040000	+ 600 000 Leke

2. Pas miratimit nga Keshilli Bashkiak, e hartohet nje aktmareveshje me Bashkise dhe Agjensise Rajonale te Zhvillimit, ku do te percaktohen te drejtat dhe detyrimet e seciles pale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Marketingut dhe Turizmit, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike.

4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETAR

Gjergji PENDAVINJI

